

1 E enjte, 1 tetor 2020

2 [Paraqitja e parë]

3 [Seancë e hapur]

4 [I dyshuari Gucati hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Fillon në orën 15.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: Mirëdita. Mirë se erdhët të gjithë
7 brenda dhe jashtë sallës së gjykatës.

8 Përpara se të fillojmë, në bazë të vendimit për caktimin
9 e datës së paraqitjes së parë, fotografi i gjykatës lejohet të
10 bëjë disa fotografi për një minutë e gjysmë. Ju faleminderit.

11 A mund ta aktivizoni mikrofonin. Faleminderit.

12 Z. REES: Do të ngrija një çështje të shkurtër lidhur me
13 fotografitë. Nuk kundërshtojmë bërjen e fotografive, por vë në
14 pikëpyetje praninë e oficerëve të sigurisë rreth z. Gucati kur
15 bëhet kjo fotografi. Pra, pyes në qoftë se është e nevojshme
16 që këto fotografi të bëhen me oficerët përreth z. Gucati, kur
17 e dimë se salla e gjykatës, e gjyqit është vend i sigurt.

18 GJYKATËSI GUILLOU: Atëherë, a do të ishte e pranueshme
19 për ju që klienti juaj të fotografohet pa praninë e oficerëve
20 të sigurisë?

21 Z. REES: Po. Pra, klienti im nuk kundërshton që të
22 fotografohet, por unë kam kundërshtim në emër të tij që në
23 këto fotografi të mos të jenë të pranishëm oficerët e
24 sigurisë.

25 GJYKATËSI GUILLOU: Për pjesën e parë të kërkesës suaj, e

1 kam të qartë, do ta urdhërojmë fotografimin që të mos bëjë
2 fotografi me klientin tuaj në shoqërinë e këtyre oficerëve të
3 sigurisë përreth tij.

4 Së dyti, është një praktikë e zakonshme që në një sallë
5 gjyqi, tribunal ndërkombëtar, dhe madje edhe në gjykata
6 kombëtare, kur një i dyshuar apo i akuzuar i cili është në
7 paraburgim është i shoqëruar me oficerë të sigurimit.

8 Urdhëroni zonja prokurore.

9 ZNJ. BOLICI: Po, ju faleminderit i nderuar gjykatës.
10 Prokurori është gjithashtu në favor të konfirmimit të
11 vazhdimit të praktikës të prezencës së oficerëve të sigurisë
12 në sallën e gjyqit derisa një i akuzuar apo i dyshuar është i
13 pranishëm.

14 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit zonja prokurore.

15 Urdhëroni zoti avokat.

16 Z. REES: Ishte kjo një pikë e shkurtër zoti gjykatës,
17 dhe këtë e bëra. Në të ardhmen ndoshta do të bëj parashtime
18 të tjera.

19 GJYKATËSI GUILLOU: Ju faleminderit.

20 Zonja fotografe, ju lutem, bëni fotografimin e të
21 dyshuarit vetëm prej afër. Pra, pa pasur në sfond fotografimin
22 e oficerëve të sigurimit.

23 Ju faleminderit zonja fotografe. Tani mund të largoheni.

24 Zonja sekretare e gjykatës, a mund të paraqisni çështjen?

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: Faleminderit i nderuar gjykatës.

1 Lënda KSC-BC-2020-07 e Prokurorit të Specializuar kundër Hysni
2 Gucatit dhe Nasim Haradinajt. Faleminderit.

3 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit zonja sekretare.

4 Përpara se t'ju kërkoj të pranishmëve që të prezantohen,
5 dua që t'ju kujtoj të gjithëve disa rregulla bazë që duhet të
6 respektohen gjatë gjithë kohës për ecurinë e duhur të seancës.

7 Prandaj ju lutem ndizni mikrofonin përpara se të filloni
8 të flisni dhe e fikni atë kur të keni përfunduar. Flisni
9 ngadalë dhe qartë, sepse kemi përkthim në shqip dhe serbisht
10 dhe prej këtyre gjuhëve në anglisht. Prisni pesë sekonda
11 përpara se të më përgjigjeni mua, një pale ose pjesëmarrësi,
12 në mënyrë që përkthyesit të kenë kohë të përfundojnë
13 përkthimin.

14 Ajo që thuhet në këtë seancë transkriptohet në kohë reale
15 dhe reflektohet në një procesverbal i cili ju vihet në
16 dispozicion palëve dhe publikut pas seancës.

17 Gjithashtu dua t'i kujtoj palët -- që një pjesë e
18 informacionit në këtë çështje është objekt i masave mbrojtëse
19 dhe urdhrave për konfidencialitet. Informacioni konfidencial
20 nuk nxirret në seancë publike. Nëse një palë ose pjesëmarrës
21 do të kalojnë në seancë private për t'iu referuar një
22 informacioni konfidencial, atëherë duhet t'i paraqes arsyet
23 për këtë.

24 Tani ju kërkoj palëve dhe pjesëmarrësve që të
25 prezantohen. Do të fillojmë me Zyrën e Prokurorit të

1 Specializuar.

2 Zonja prokurore.

3 ZNJ. BOLICI: Faleminderit. Për Zyrën e Prokurorit të
4 Specializuar të pranishëm janë, z. Jack Smith, Prokuror i
5 Specializuar; z. Alex Whiting, Zëvendësprokuror i
6 Specializuar; z. James Pace, ndihmësprokuror; Line Pedersen,
7 administratore e çështjes; dhe unë jam Valeria Bolici,
8 prokurore në Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

9 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit.

10 Tani për mbrojtjen, në qoftë se avokati mund t'i
11 prezantojë përfaqësuesit e mbrojtjes.

12 Z. REES: Unë jam Jonathan Elystan Rees. Jam mbrojtës i
13 z. Gucati. Kam asistencën e bashkëmbrojtësit Valon Hasanit dhe
14 anëtarit të ekipit të mbrojtjes z. Huw Bouden.

15 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit.

16 Për hir të procesverbalit, i pranishëm në sallë është
17 edhe i dyshuari z. Gucati.

18 Tani radhën e ka Zyra Administrative.

19 ADMINISTRATORJA: Faleminderit. Fidelma Donlon,
20 Administratore.

21 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit zonja Administratore.

22 Për hir të procesverbalit, unë jam Nicolas Guillou,
23 gjykatës i vetëm në këtë çështje.

24 I dyshuari paraqitet sot për herë të parë para Dhomave të
25 Specializuara pas arrestimit dhe transferimit të tij. E di që

1 z. Gucati ka bërë të ditur se nuk ka mundur të jetë i
2 pranishëm për seancës e paraqitjes së parë përpara ditës së
3 sotme. Këtë e kam marrë parasysh kur kam nxjerrë urdhrin për
4 caktimin e datës 29 shtator 2020.

5 Tani do t'i drejtohem z. Gucati.

6 A mund të ngriheni në këmbë ju lutem z. Gucati.

7 Po, mund ta ndizni mikrofonin te ajo pulla në të djathtë.

8 Na e thoni emrin dhe mbiemrin e plotë ju lutem?

9 I DYSHUARI GUCATI: Quhem Hysni Gucati.

10 GJYKATËSI GUILLOU: Data dhe vendi i lindjes?

11 I DYSHUARI GUCATI: Më 30 mars 1967. Fshati Morinë,
12 komuna Skënderaj.

13 GJYKATËSI GUILLOU: Shtetësia juaj?

14 I DYSHUARI GUCATI: Kosovare.

15 GJYKATËSI GUILLOU: Çfarë pune bëni aktualisht?

16 Profesioni juaj aktual?

17 I DYSHUARI GUCATI: Unë jam sekretar i shkollës fillore
18 'Ahmet Delia', dhe ndërkohë jam kryetar i Organizatës të
19 Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

20 GJYKATËSI GUILLOU: Ju faleminderit.

21 Përpara se të vazhdojmë, dua që të më konfirmoni se mund
22 t'i ndiqni këto procedura në një gjuhë që e flisni dhe e
23 kuptoni. A mund, ju lutem, të më konfirmoni që e flisni dhe e
24 kuptoni gjuhën shqipe?

25 I DYSHUARI GUCATI: Po. E flas dhe e kuptoj gjuhën

1 shqipe.

2 GJYKATËSI GUILLOU: Ju faleminderit z. Gucati.

3 Me këtë konfirmim jam i bindur se mund t'i ndiqni
4 procedurat në gjuhën shqipe si gjuhë që e kuptoni dhe e
5 flisni, në përputhje me nenin 41.

6 Në qoftë se në një moment gjatë kësaj seance nuk merrni
7 përkthimin, ju lutem të më informoni menjëherë.

8 I DYSHUARI GUCATI: Ju faleminderit.

9 GJYKATËSI GUILLOU: Ju faleminderit z. Gucati. Mund të
10 uleni.

11 Tani do të kaloj në historikun procedural të kësaj
12 çështje.

13 Më 24 shtator 2020, si gjykatës i vetëm, lëshova
14 fletarrestim për të dyshuarin, pasi konstatova se ekziston
15 dyshim i bazuar që z. Gucati mban përgjegjësi penale për
16 veprat penale në vijim:

17 Frikësim gjatë procedimit penal, në bazë të nenit 387 të
18 Kodit Penal të Kosovës;

19 Hakmarrje, në bazë të nenit 388 të Kodit Penal të
20 Kosovës; dhe

21 Shkelje të fshehtësisë së procedurës, në bazë të nenit
22 392 të Kodit Penal të Kosovës.

23 Ndjekja penale e këtyre veprave është brenda
24 juridiksionit të Dhomave të Specializuara, në përputhje me
25 nenin 15 të Ligjit për Dhomat e Specializuara të Kosovës.

1 I dyshuari u arrestua në Kosovë më 25 shtator 2020, kur
2 edhe iu dorëzua fletarrestimi dhe u informua për të drejtat e
3 tij.

4 Në të njëjtën ditë ai u transferua në objektin e
5 paraburgimit të Dhomave të Specializuara të -- Kosovës në
6 Hagë.

7 Ka pasur disa parashtrime të reja në këtë çështje.

8 Z. Gucati, kam para vetes katër kërkesa ku kundërshtohen
9 aspekte të ndryshme të arrestimit dhe paraburgimit tuaj.

10 Lidhur me këto kërkesa, udhëzoj Zyrën e Prokurorit të
11 Specializuar që të parashtrojë një përgjigje të konsoliduar,
12 më së voni deri të premtën më 9 tetor.

13 ZNJ. BOLICI: Në rregull.

14 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit.

15 Dhe z. Rees, ju e dini që dje kam nxjerrë dy urdhra. Një
16 urdhër për riklasifikimin e parashtrimeve dhe një urdhër për
17 gjuhën e punës të procedurës.

18 Lidhur me urdhrin për riklasifikim, kam bërë të ditur se
19 kam ndërmend të bëj riklasifikimin e dokumenteve në dosjen e
20 çështjes sa më shpejt që është e mundur, në mënyrë që mbrojtja
21 të ketë qasje në të gjitha parashtrimet lidhur me arrestimin
22 dhe paraburgimin e z. Gucati. Zyra e Prokurorit të
23 Specializuar dhe Zyra Administrative kanë afatin deri më 14
24 tetor që të përgjigjen.

25 Tani më lejoni të shpjegoj qëllimin e seancës së

1 paraqitjes së parë, në mënyrë që të jetë e qartë për të
2 dyshuarin dhe ata që na ndjekin nga galeria për publikun dhe
3 online.

4 Seanca e sotme nuk është gjykim. Nuk janë ngritur ende
5 akuza kundër të dyshuarit. D.m.th., nuk është paraqitur ende
6 aktakuzë nga Prokurori i Specializuar. Në këtë seancë nuk do
7 të paraqiten dhe as debatohen prova. Nuk do të diskohet dhe as
8 përcaktohet fajësia ose pafajësia e të dyshuarit.

9 Qëllimi i kësaj paraqitje të parë rregullohet me nenin 41
10 të Ligjit dhe rregullën 55 të Rregullores. Sipas këtyre
11 dispozitave, unë si gjykatës i vetëm, dua të konfirmoj apo
12 verifikoj:

13 Nëse i dyshuari është i informuar për arsyet e arrestimit
14 të tij, përkatësisht, për veprat e pretenduara penale dhe për
15 arsyet e mbajtjes së tij në paraburgim; dhe

16 Nëse i dyshuari është i informuar për të drejtat që i
17 takojnë në bazë të Ligjit dhe Rregullores, duke përfshirë të
18 drejtën e tij për ndihmë juridike.

19 Pres nga palët që t'i kufizojnë parashtrimet e veta
20 brenda këtyre pikave, të cilat do t'i adresoj veç e veç.

21 Nëse ndonjëra prej palëve dëshiron të diskutojë ndonjë
22 çështje tjetër që nuk është paraparë shprehimisht në kuadër të
23 paraqitjes së parë, këtë mund ta bëjnë me anë të parashtrimeve
24 me shkrim.

25 Së pari, z. Gucati, a mund të më konfirmoni se ju është

1 dorëzuar fletarrestimi i datës 24 shtator 2020, në një gjuhë
2 që e kuptoni dhe e flisni?

3 I DYSHUARI GUCATI: Fletarrestimi më është komentuar në
4 ditën e arrestimit.

5 GJYKATËSI GUILLOU: Ju faleminderit z. Gucati.

6 Tani do t'i kërkoj sekretares së gjykatës që t'i lexojë
7 arsyet e arrestimit, sikurse paraqiten në fletarrestim.

8 Urdhëroni.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: Faleminderit i nderuar gjykatës.

10 Sipas fletarrestimit:

11 Së pari, ekziston dyshim i bazuar se z. Gucati është
12 penalisht përgjegjës për orvatje të kryerjes së veprës penale
13 të frikësimit gjatë procedimit penal, në bazë të nenit 387 të
14 Kodit Penal të Kosovës. Konkretisht, ekziston dyshim i bazuar
15 se z. Gucati mbajti tri konferenca për shtyp më datat 7, 16
16 dhe 22 shtator 2020, ku ai shpërndau, ose vuri në dispozicion
17 të medias informacion dhe dokumente konfidenciale dhe
18 jopublike që kanë lidhje me punën e Zyrës së Prokurorit të
19 Specializuar, dhe nuk bëri asnjë ndërhyrje kur Nasim Haradinaj
20 përmendi me emër disa dëshmitarë të mundshëm dhe përmendi të
21 dhëna në lidhje me -- vendbanimin e tyre dhe të dhëna të tjera
22 personale.

23 Kjo sjellje përbën kërcënim të rëndë, ose mënyrë tjetër
24 shtrëngimi që e nxit një person të mos japë deklaratë, ose të
25 japë deklaratë të rreme, ose që të mos i japë informacion të

1 vërtetë Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe/ose Dhomave të
2 Specializuara.

3 Së dyti, ekziston dyshim i bazuar se z. Gucati është
4 penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale të
5 hakmarrjes, sipas nenit 388 të Kodit Penal të Kosovës.
6 Konkretisht, ekziston dyshim i bazuar se z. Gucati mbajti tri
7 konferenca për shtyp më datë 7, 16, dhe 22 shtator 2020, ku ai
8 shpërndau, ose vuri në dispozicion të mediave informacion dhe
9 dokumente konfidenciale dhe jopublike që kanë lidhje me punën
10 e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, ku përfshihen emra dhe
11 të dhëna personale të dëshmitarëve të mundshëm, duke i
12 ekspozuar në këtë mënyrë këta individë me kërcënime të
13 mundshme kundër sigurisë së tyre.

14 Kjo sjellje përbën një veprim të dëmshëm me synimin e
15 hakmarrjes për dhënien e informacionit të besueshëm Task
16 Forcës Hetimore Speciale dhe/ose Zyrës së Prokurorit të
17 Specializuar në lidhje me pretendime për kryerje të veprave
18 penale.

19 Së treti, ekziston dyshim i bazuar se Z. Gucati është
20 penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale të shkeljes
21 së fshehtësisë së procedurës, sipas nenit 392 të Kodit Penal
22 të Kosovës. Konkretisht, ekziston dyshim i bazuar se z. Gucati
23 ka mbajtur tri konferenca për shtyp më datat 7, 16 dhe 22
24 shtator 2020, ku ai shpërndau, ose ndryshe vuri në dispozicion
25 të medias informacion dhe dokumente konfidenciale dhe

1 jopublike që kanë lidhje me punën e Zyrës së Prokurorit të
2 Specializuar, përfshirë dhe emrat dhe të dhëna personale të
3 dëshmitarëve të mundshëm.

4 Po ashtu, ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar
5 se arrestimi i z. Gucati është i domosdoshëm sepse rrethanat
6 konkrete tregojnë se ai:

7 (i) është rrezik të arratiset;

8 (ii) ai ka motivin, mjetet dhe mundësinë për të penguar
9 ecurinë e procedimit penal; dhe

10 (iii) do të përsërisë ose do të orvatet të kryejë përsëri
11 veprat penale.

12 Faleminderit i nderuar gjykatës.

13 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit sekretare e gjykatës.

14 Z. Gucati, dua t'ju kujtoj se kjo nuk është koha për të
15 kundërshtuar arsyet e arrestimit tuaj sot, por që të pranoni
16 se jeni informuar dhe keni dijeni për këto arsye.

17 Do të keni mundësi të bëni ankesë kundër arrestimit tuaj,
18 me shkrim me ndihmën e avokatit tuaj mbrojtës.

19 Z. Gucati, a mund të konfirmoni ju lutem që jeni
20 informuar për arsyet e arrestimin tuaj?

21 I DYSHUARI GUCATI: Nuk jam i informu për arrestim tim
22 deri në atë moment kur më është ardh policia e EULEX-it në
23 zyrën time.

24 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit z. Gucati.

25 Doni të shtoni diçka për këtë? Sa keni pritur?

1 Nëse keni diçka konkrete për të shtuar mund ta shtoni?

2 I DYSHUARI GUCATI: Edhe njëherë pyetjen nëse ka mundësi,
3 se s'po kuptoj?

4 GJYKATËSI GUILLOU: Ka një problem me përkthimin. Ju
5 pyeta nëse keni diçka për të shtuar. Ju pyeta nëse kishte
6 diçka për të shtuar, fakti që u informuat kur arriti policia e
7 EULEX-it. Dhe mendoj që kishte një problem me përkthimin këtu.

8 A mund të përgjigjeni dhe njëherë z. Gucati?

9 I DYSHUARI GUCATI: Jo, unë s'kam çka të shtoj tjetër.

10 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit.

11 A mund të konfirmoni se keni pasur mundësinë të njoftoni,
12 ose që dikush tjetër të njoftonte në emrin tuaj një anëtar të
13 familjes apo një person tjetër të përshtatshëm për arrestimin
14 tuaj?

15 I DYSHUARI GUCATI: Jo. Kanë mujt me më njoftu vetëm mua,
16 po edhe dikën prej familjes s'ka pas problem. Nuk ka pas
17 nevojë të hyjnë në atë formë çfarë kanë hy policia e EULEX-it
18 në Organizatën e Veteranëve. Kanë mujt të më ftojnë mua edhe
19 unë do të isha dorëzuar vetë.

20 GJYKATËSI GUILLOU: E kuptoj atë që po thoni ju, por unë
21 po ju pyes, kur u arrestuat, a patën mundësi të informoni një
22 anëtar të familjes apo një person tjetër për arrestimin tuaj,
23 që u arrestuat?

24 I DYSHUARI GUCATI: Dikund rreth një orë e gjys, mbas një
25 orë e gjys e kam informuar djalin tim se jam arrestuar.

1 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit z. Gucati.

2 Tani t'ju informoj për të drejtat që keni para kësaj
3 gjykate. Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Rregullorja e
4 Procedurës dhe e Provave i garantojnë të dyshuarve të
5 paraburgosur një numër të drejtash. Do t'ju lexoj më të
6 rëndësishmet.

7 Së pari, ju prezumoheni i pafajshëm derisa të provohet
8 fajësia juaj përtej dyshimit të arsyeshëm.

9 Ju keni të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, në
10 varësi të ndonjë mase që urdhërohet për mbrojtjen e viktimave
11 dhe dëshmitarëve.

12 Ju keni të drejtë të paraqisni ankesë kundër ligjshmërisë
13 së arrestimit tuaj dhe të kërkonit rishikimin e vendimeve për
14 arrestimin tuaj, dhe t'i apelonit këto vendime drejtpërsëdrejti
15 në Gjykatën e Apelit.

16 Keni të drejtë të mos mbaheni në paraburgim për një
17 periudhë të paarsyeshme kohe përpara hapjes së çështjes, dhe
18 keni të drejtën të liroheni në qoftë se Prokurori i
19 Specializuar nuk dorëzon aktakuzë kundër jush -- më së shumti
20 brenda një viti.

21 Keni të drejtën e një gjykimi brenda një kohe të
22 arsyeshme, ose të liroheni në pritje të gjykimit në qoftë se
23 plotësohen kushtet.

24 Keni të drejtën t'ju caktohet një mbrojtës pa pagesë nga
25 ju, në qoftë se nuk keni mjetet për të paguar për të.

1 Keni të drejtën të keni kohën dhe mjetet e mjaftueshme
2 për përgatitjen e mbrojtjes tuaj dhe të komunikoni me
3 mbrojtësin që e zgjidhni vetë.

4 Keni të drejtën që të ndihmoheni pa pagesë nga një
5 përkthyes në qoftë se nuk e kuptoni apo nuk e flisni gjuhën që
6 përdoret në gjykatë.

7 Keni të drejtën të mos detyroheni të dëshmoni kundër
8 vetes apo të pranoni fajësinë.

9 Dhe keni të drejtën të qëndroni i heshtur, dhe nuk do të
10 nxirret asnjë përfundim negativ për ju nga heshtja juaj.

11 Z. Gucati, i dëgjuat të drejtat më të rëndësishme që
12 gëzoni si i dyshuar në paraburgim në përputhje me kornizën
13 ligjore të zbatueshme të Dhomave të Specializuara.

14 A i kuptoni këto të drejta?

15 I DYSHUARI GUCATI: Po. Faleminderit.

16 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit z. Gucati.

17 Dua t'ju informoj se në bazë të nenit 21(5) e Ligjit, ju
18 nuk lejoheni të përfaqësoni vetveten sepse jeni në paraburgim.
19 Prandaj, është e detyrueshme përfaqësimi nga një mbrojtës i
20 specializuar.

21 Është detyra ime si gjykatës i vetëm, të siguroj që e
22 drejta juaj për të pasur mbrojtës të respektohet. Për këtë unë
23 kam marrë shënim parashtrimin e Administratores të datës 28
24 shtator, që informon panelin për emërimin e mbrojtësit dhe
25 bashkëmbrojtësit.

1 Dhe unë ju informoj që keni të drejtën të përfaqësoheni
2 nga mbrojtësi i emëruar për të gjithë kohëzgjatjen e
3 procedurës. Në qoftë se në çfarëdo momenti nuk keni mjete të
4 mjaftueshme të paguani mbrojtësin, mund të bëni kërkesë, të
5 shpalleni i varfër, dhe në këtë rast do t'ju caktohet
6 mbrojtës.

7 Në këtë fazë dëshiroj të ftoj Prokurorin e Specializuar
8 që të na informojë lidhur me hapat e mëtutjeshme procedurale,
9 veçanërisht, për atë se kur ka ndërmend të dorëzojë aktakuzë
10 kundër z. Gucati.

11 Disa parashtrime për këtë temë janë bërë edhe gjatë
12 paraqitjes së parë të z. Haradinaj të martën, por i dyshuari,
13 z. Gucati, nuk ishte i pranishëm aty. Unë e di që në këtë
14 moment mund të mos kemi -- afate kohore të përcaktuara të
15 qarta, por dua t'i kujtoj Prokurorit që kemi dy të dyshuar
16 tani në paraburgim, dhe duhet që procesi gjyqësor të jetë i
17 drejtë dhe i shpejtë.

18 ZNJ. BOLICI: Siç e thashë edhe në seancën e mëparshme,
19 që u mbajt më 29 shtator, në lidhje me këtë çështje,
20 shpejtësia e procedurës është një prioritet absolut për Zyrën
21 e Prokurorit të Specializuar.

22 Po në të njëjtën kohë, është shumë e rëndësishme që të
23 jenë të plota -- të gjithë materialet provuese të jetë të
24 plota, dhe kjo është një prioritet i zyrës tonë, është në
25 interes të të gjitha palëve në këtë procedurë edhe në interes

1 të të dyshuarve, si edhe në interes të gjykatës.

2 Unë vë në dukje se veprat penale për të cilat është
3 konstatuar dyshim i bazuar janë deri në datën 22 shtator 2020,
4 që është rreth një javë më parë. Siç e kemi vënë në dukje dhe
5 më parë, janë disa hapa të domosdoshme hetimore që po ndërmer
6 zyra jonë, përfshi edhe mbledhjen e informacioneve nga
7 dëshmitarët të cilët janë ndjerë të kërcënuar, transkriptimi
8 dhe përkthimi i materiale përkatëse audiovizuale, kërkesa e
9 dokumenteve nga palë të treta, si dhe analizimi i materialeve
10 të sekuestruara, përfshirë kompjuterë, telefona dhe sende të
11 tjera.

12 Duke pasur parasysh të gjithë këto hapa hetimore, dhe
13 duke konfirmuar që ne jemi të përkushtuar për një proces të
14 shpejtë dhe eficient, konfirmoj që Prokuroria ka ndërmend të
15 dorëzojë aktakuzën brenda një periudhë 30-ditore.

16 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit zonja prokurore.

17 E përmend për procesverbalin, që unë e përmenda
18 parashtrimin e bërë nga Administratorja më datë 28 shtator. Në
19 fakt e kisha fjalën, është parashtrim i Zyrës Administrative.

20 Dua tani që palët të thonë nëse kanë ndonjë çështje
21 urgjente që duan të ngrenë, që nuk mund të trajtohet përmes
22 parashtrimeve me shkrim. Ju kujtoj që në qoftë se ata -- do të
23 përmendin materiale konfidenciale, duhet ta njoftojnë
24 paraprkisht në mënyrë që të merren masat e duhura.

25 Z. Rees, keni fjalën. Desha të përmend që ne i kemi marrë

1 parashtrimet tuaja të datave 28, 29 dhe 30 shtator, si dhe të
2 1 tetorit. Nuk keni nevojë të hyni në hollësi për këto, por
3 mund të shtoni diçka.

4 Z. REES: Siç e ka pranuar z. Gucati, ai e ka
5 kundërshtuar me shkrim ligjshmërinë e arrestimin dhe
6 transferimin -- si dhe çështjet faktuale që ngrihen brenda
7 fletarrestimit.

8 Ju keni kërkuar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar që
9 të bëjë parashtrime me shkrim në lidhje me këto pika. Dhe nga
10 kjo kuptoj që ju i nderuar gjykatës nuk mund t'i trajtoni këto
11 çështje që janë ngritur sot në argumentimin e sotëm.

12 Kam nja dy gjëra që duhet t'i ngre me gojë sepse është
13 çështja e lirimit me kusht, sepse -- Prokurorisë i është dhënë
14 kohë -- që t'i përgjigjet kundërshtimeve me shkrim për
15 ligjshmërinë e arrestimit. Kurse, ndërkohë z. Gucati është në
16 paraburgim dhe do të mbetet në paraburgim, ndërkohë që pret
17 përgjigjen e Prokurorisë, dhe mbas kësaj mundësia e gjykatës
18 për të shqyrtuar parashtrimet me shkrim të bëra si nga z.
19 Gucati ashtu edhe ZPS-ja.

20 Për këtë arsye kërkoj nga ju i nderuar gjykatës që të
21 merrni parasysh mundësinë e dhënies së lirimit me kusht për
22 të. Unë kam bërë një parashtrim me shkrim ku ngrihet çështja e
23 lirimit me kusht. Unë them që pavarësisht nga kjo dhe pa
24 dëmtuar ato kundërshtime që kemi bërë përpara për sa i përket
25 ligjshmërisë së arrestimit dhe të mbajtjes në paraburgim,

1 është e drejtë që gjykata në këto rrethana kur kemi
2 kundërshtime që janë parashtruar dhe nuk janë trajtuar ende,
3 të mendojë për dhënien e lirimit me kusht. Sidomos neni 40(1)
4 pika (ii) e Ligjit flet për të drejtën e një vendosjeje të
5 shpejtë të çështjeve që lidhen me paraburgimin. Prandaj ju
6 kërkoj i nderuar gjykatës që të merrni parasysh mundësinë e
7 dhënies së lirimit me kusht ndërkohë që këto çështje janë ende
8 pezull, për të cilat nuk është marrë vendim ende.

9 Gjithashtu, pa paragjykim për parashtrimet që kam bërë në
10 lidhje me arrestimin vetë që ne themi se është i paligjshëm,
11 dhe pa pranuar çështjet faktuale që ekzistojnë në lidhje me
12 këto tri çështje dhe të cilat duhen plotësuar në rastin e z.
13 Gucati, duke dhënë lirim me kusht në një paketë parashtrimesh
14 të cilat janë caktuar për t'ju përgjigjur atyre rreziqeve.

15 Dhe në qoftë se gjykata bie dakord që këtyre rreziqeve iu
16 kthehet përgjigje, atëherë kjo nuk e justifikon më mbajtjen e
17 tij në paraburgim.

18 Sa për t'ju dhënë pak histori për z. Gucati. Z. Gucati
19 është babai i shtatë fëmijëve. Të gjithë jetojnë në zonën e
20 Skënderajt. Është zona ku ai ka lindur. Ai ka lidhja të forta
21 familjare në atë zonë. Ka fëmijë të moshës midis 23 deri në 34
22 vjeç. Po kështu ka edhe nipër e mbesa që jetojnë në Skënderaj.
23 E gjitha familja jeton atje. Nipi i tij më i vogël është rreth
24 katër muaj e gjysmë, më i madhi është rreth nëntë vjeç.

25 Ai nuk është me shëndet mirë. Vuan nga diabeti i tipit

1 dy. Merr insulinë dhe vuan nga -- shtypja e lartë e gjakut. Ai
2 ka kështu edhe probleme me lëvizshmërinë sepse p.sh., sot ai
3 kishte një termin në spital në Prishtinë për qëllime të
4 kryerjes së një operacioni më vonë për të zgjidhur këto
5 problemet e lëvizshmërisë.

6 Po kështu vuan nga astma. Dhe siç e dëgjuat ai ka punuar
7 për trembëdhjetë vjet e gjysmë si sekretar në një shkollë në
8 Skënderaj. Ai ka lidhje të forta komunitare në atë zonë.

9 Në këto rrethana, sipas parashtrimit tim, mund të jepet
10 liri me kusht, me kushtet e mëposhtme që janë parashtruar edhe
11 me shkrim edhe që Prokuroria ka pasur mundësi t'i shikojë.
12 Pra, ne mund të ofrojmë një garanci 5000 euro, që ai të
13 jetojnë në adresën që do të përcaktohet, që të raportojë në
14 policinë e EULEX-it.

15 Dhe të gjitha këto kushte së bashku, me faktin që ai ka
16 familje, fëmijë, nipër, mbesa aty, të gjitha këto i
17 plotësojnë, i përgjigjen atij rreziku të rrezikut të
18 arratisjes.

19 Po kështu kemi dhënë edhe parashtrim me shkrim në lidhje
20 me lirimin me kusht, dhe kemi thënë që ne mund të marrim
21 parasysh që ai mos të kontaktojë direkt apo indirekt ndonjë
22 person që gjykata mendon nuk duhet ta kontaktojë. Z. Gucati
23 është i vendosur që do t'i përmbahet të gjitha rregullave që i
24 caktohen dhe kushteve që i caktohen ndërkohë që vendoset
25 çështja e tij.

1 Dhe ne kemi propozuar edhe një kusht, që z. Gucati mos
2 t'i afrohet -- d.m.th., deri në largësinë 100 metra zyrës së
3 Organizatës së Veteranëve të Luftës. Ai e kupton që gjatë
4 kohës që është çështja e tij ende për gjykim duhet ta bëjë
5 këtë. Dhe ekziston edhe një çështje në lidhje me çështjet
6 faktuale që përmbahen në fletarrestim, që gjykata duhet të
7 konsiderojë kufizimin e rolit të tij aktiv ndërkohë që
8 vendoset çështja e tij. Dhe ai do t'i përmbahet të gjitha
9 kushteve që do t'i jepen.

10 Unë parashtroj se në qoftë se i jepet lirimi me kusht me
11 këto kushte që përmenda, -- kjo i përgjigjet plotësisht të
12 gjitha çështjeve që ngrihen në nenin 41(6)(b). Pra, rreziku i
13 arratisjes, pengimi i drejtësisë dhe kryerja e veprave penale
14 të tjera.

15 Duke pasur parasysh këtë sfond, këtë historik të z.
16 Gucati, që ai ka bashkëpunuar në arrestim, që nuk ka marrë
17 ende aktakuzë për veprat penale, dhe se këto çështje që po
18 hetohen nuk përbëjnë pretendime që është përdorur forcë gjatë
19 arrestimit të tij.

20 Po kështu, do të ishte proporcionale dhe e duhur që të
21 konsiderohet mundësia e dhënies së lirimit me kusht gjatë
22 kohës që ai është në paraburgim. Duke pasur parasysh se veprat
23 penale për të cilat ai po hetohet, nuk janë vepra penale
24 substantive, materiale që bien brenda juridiksionit të kësaj
25 gjykate, por janë vepra penale që lidhen me administrimin e

1 drejtësisë, që dalin nga, ose që bazohen në Kodin e Procedurës
2 Penale të Kosovës. Dhe këto kanë një dënim të parashikuar deri
3 në dhjetë vjet, po gama është nga dy deri në dhjetë vjet.

4 Dhe në këto rrethana pra, kur këto vepra penale nuk
5 përfshijnë pretendime të kërcënimeve faktike apo forcës
6 faktike, apo lëndimit faktik të shkaktuar prej tij, unë them
7 që është e përshtatshme që gjykata të japë lirim me kusht, me
8 kushtet që u propozuan, deri në ankimimin që do t'i bëjë ai
9 arrestimit dhe mbajtjes së tij në paraburgim.

10 Kaq kisha për të thënë.

11 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit i nderuar avokat.

12 Zonja prokurore keni diçka për të thënë për këtë?

13 ZNJ. BOLICI: Ndërkohë që Zyra e Prokurorit të
14 Specializuar do të përgjigjet me shkrim siç u udhëzua prej
15 jush i nderuar gjykatës, ka disa çështje që do të doja të
16 ngrija.

17 Paraburgimi i z. Gucati mbetet absolutisht i nevojshëm në
18 këtë fazë, duke pasur parasysh se nuk ka rrethana të reja që
19 kanë dalë që mund të ndikojnë negativisht në gjetje të cilat
20 janë dhënë në aktakuzë. Pra, dhe do të doja të thoja që për atë
21 kohë sa kemi të njëjtat kushte që ekzistojnë që në momentin që
22 është arrestuar z. Gucati, ka edhe elementë të rinj që do të
23 duhen të shqyrtohen prej nesh lidhur me të.

24 Që prej lëshimit të fletarrestimit, në fakt z. Gucati
25 është njoftuar për veprën penale për të cilat ai është ndaluar

1 si edhe sanksionet e parashikuara në kuadrin e kryerjes së
2 këtyre veprave. Dhe në këtë rrethanë ne kemi motive të tjera
3 shtesë për z. Gucati që mund t'i shmanget drejtësisë.

4 Megjithatë, mbi të gjitha, në disa deklarata të mëparshme
5 publike z. Gucati ka afirmuar publikisht që ai do të vazhdojë
6 që të bëjë publik informacione, çdo informacione e të tjera që
7 mund t'i bien në posedim të cilat kanë të bëjnë me fushën apo
8 lëndën e kësaj gjykate. Dhe ai ka ndërmarrë veprime duke
9 njoftuar qëllimisht, le të themi, përbërjen e dosjeve.

10 Z. Gucati i ka bërë deklarata të tilla deri në ditën e
11 arrestimit dhe si rezultat ekziston, le të themi, rreziku i
12 përsëritjes ose orvatjeve për t'u kryer përsëri veprat penale.
13 Dhe në fakt kjo përsëritje apo kjo tendencë është ndaluar
14 vetëm përmes arrestimit të z. Gucati.

15 Zyra e Prokurorit të Specializuar mendon që në qoftë se
16 z. Gucati do të lirohet, ai do të vazhdojë që të përsërisë të
17 njëjtën vepër dhe të sillet njësoj. Jo vetëm kaq, po ai do të
18 mbështetet në të njëjtin rrjet mbështetësish. Dhe përveç
19 kësaj, do të doja të theksoja që sot është bërë publike që një
20 organizatë në të cilën z. Gucati merr pjesë dhe e drejton,
21 pra, është urdhëruar që të mos botojë, të mos zbulojë
22 informacione për publikun të cilat lidhen me procese gjyqësore
23 të kësaj gjykate, të institucioneve tona.

24 Sa i takon këtij aspekti dhe duke pasur dhe elementë dhe
25 arsye të tjera të parashtrimeve me shkrim, zyra jonë është e

1 mendimet që kushtet që janë parashtruar nga mbrojtësi i z.
2 Gucati janë tërësisht të pabindshme, në mënyrë që mund të
3 kërkohet, le të themi, parashtrimi i dhënë në nenin 41(6) dhe
4 të lihet z. Gucati pra, të lirohet me kusht.

5 Z. REES: Më lejoni të them diçka. Ka një ndryshim
6 rrethanash që prej momentit kur është lëshuar fletarrestimi,
7 dhe ne kemi parashtruar një paketë gjithëpërfshirëse kushtesh
8 dhe gjykatësi mund t'i shqyrtojë elementet që kemi parashikuar
9 në qoftë se përmbushen kushtet e rregullës dhe nenit në fjalë.

10 Dhe do të doja të thoja që ne do të vazhdojmë të
11 kundërshtojmë në kohën e duhur, por ndërkohë ajo çfarë po
12 kërkohet unë tani është lirim me kusht për periudhën derisa të
13 bëhen parashtrimet nga pala tjetër.

14 Pra, ka një kërkesë për zbulimin e provave mbi të cilën
15 është mbështetur fletarrestimi në mënyrë që mbi bazën e tij të
16 mund të bëheshin parashtrimet, dhe kjo kërkesë për Zyrën e
17 Prokurorit të Specializuar është refuzuar. Dhe në fakt ju jam
18 mirënjohës se që në fillim fare ju thatë që ju keni dhënë
19 kërkesën për, le të themi, zbulimin e informacionit sepse Zyra
20 e Prokurorit të Specializuar ka refuzuar që të bënte publike
21 dhe të zbulonte të dhënat që na nevojiten.

22 Pra, -- ajo çfarë po mundohem që të bëj është që t'i
23 referohem kushteve që i përmenda më sipër dhe ato të merren
24 parasysh. Pra, pozicioni juaj zoti gjykatës është përcaktuar
25 shumë qartë. Që në fillim fare thatë që nuk do të përmendim

1 provat, nuk është qëllimi kryesor i kësaj seance që të merremi
2 me provat, por në fakt Prokuroria ka dëshmuar tërësisht të
3 kundërtën.

4 Do të doja t'ju kërkoja dhe njëherë që të merrni parasysh
5 parashtrimin tonë. Dhe sërish unë do të doja të thoja që ne
6 kemi depozituar një parashtrim që kundërshton ligjshmërinë e
7 fletarrestimit. Dhe ndërkohë që juve, siç e thatë i nderuar
8 zoti gjykatës, keni kërkuar parashtrimet me shkrim, ajo çfarë
9 po kërkojmë neve është që ne duam që të marrim, le të themi,
10 të marrim përgjigjen nga juve edhe të kemi lirimin me kusht
11 domethënë.

12 Dhe mendoj që të gjitha arsyet të cilat janë dhënë në
13 parashtrimin tonë janë të arsyeshme, duke marrë parasysh
14 çështjet për të cilat akuzohet z. Gucati, natyrën dhe le të
15 themi, edhe veprat të cilat mund të bien nën fushën e veprimit
16 të kësaj gjykate, dhe ne kemi propozuar një paketë të plotë
17 kushtesh të cilat i përmbushin shqetësimet e Prokurorisë.

18 ZNJ. BOLICI: Një përgjigje shumë të shkurtër, jo për
19 themelin e kërkesës për lirim me kusht që u trajtua pak më
20 përpara me ndërhyrjen time, por më lejoni të them diçka sa i
21 takon zbulimit nga Prokuroria e materialeve të këtij procesi.

22 Pra, mbrojtja ka kërkuar materiale për aktakuzën dhe
23 është informuar që nuk ka materiale të tilla. Dhe më pas na
24 është bërë një tjetër kërkesë për zbulimin dhe për dhënien e
25 informacionit. Edhe i jemi përgjigjur që ne do të japim

1 informacionet mbi bazën e procedurave ligjore dhe përmes
2 kanaleve të nevojshme.

3 E kemi theksuar që Zyra e Prokurorit të Specializuar sot
4 ka botuar d.m.th., ka dhënë një version të redaktuar për sa i
5 takon fletarrestit dhe një dokumentacion tjetër të redaktuar
6 për mbrojtjen. Dhe në përputhje me urdhrin e gjykatësit të
7 vetëm më datë 30 shtator, ne do të vazhdojmë që t'i japim të
8 gjitha dokumentet e nevojshme ashtu siç udhëzohet prej
9 gjykatësit të vetëm. Faleminderit.

10 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit zonja prokurore.

11 Pra, çështja do të trajtohet me shumë shpejtësi.

12 Ndërkohë që tani do të doja që t'i kërkoja z. Gucati të
13 shprehej në qoftë se ka çështje për të ngritur që kanë të
14 bëjnë me arrestimin, transferimin apo paraburgimin e tij.

15 Dhe ka edhe një pyetje tjetër që do të doja t'ju bëja.
16 Thjesht mbrojtësi juaj ju thërret Gucati. Ju lutem, a mund të
17 thoni sesi e keni tamam mbiemrin, në mënyrë që mund t'ju
18 shqiptojmë siç e keni vërtetë mbiemrin tuaj z. Gucati.

19 I DYSHUARI GUCATI: Mbiemri im është Gucati. Gucati. Ato
20 se çka tha mbrojtësi, unë s'kam çka të shtoj. Arrestimi im në
21 Pejë -- Prishtinë e deri në Holandë ka qenë shumë i mirë. E
22 falënderoj stafin. Se unë jam edhe invalid i luftës me
23 shkallën e invaliditetit 75% të dëmtimit të trupit. Kështu që
24 në momentin që e kanë merr vesh se jam edhe invalid lufte, ata
25 më kanë respektuar shumë deri në paraburgim. Kështu dhe në

1 paraburgim ku jam, e falënderoj stafin tërësisht që sillen në
2 mënyrën më korrekte ndaj meje tuj e pa dëmtimin e trupit dhe
3 që jam 75% invalid i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

4 Kjo është e tëra. Ato që çka tha avokati, unë nuk do --
5 s'kam se ça të shtoj diçka tjetër, dhe jam me ato përmbajtje
6 të gjitha që i thotë avokati, ato duhet të jemi.

7 GJYKATËSI GUILLOU: Emrin do ta themi siç duhet tani z.
8 Gucati.

9 I DYSHUARI GUCATI: Faleminderit prej juve.

10 GJYKATËSI GUILLOU: Z. Gucati, më lejoni t'ju them që në
11 bazë të nenit 51 dhe 57, unë do të rishikoj ndalimin tuaj,
12 paraburgimin tuaj, ose me kërkesë të avokatit mbrojtës tuajin
13 ose me iniciativën time.

14 Duke pasur parasysh llojin e veprës dhe rregullën 57, do
15 të doja që t'i kërkoja Prokurorisë që të respektojnë afatin
16 kohor sa i takon aktakuzës.

17 Ky është fundi i procesit, i procedurës së sotme.

18 Do të doja të falënderoja të gjithë palët. Do të doja të
19 falënderoja gjithashtu edhe përkthyesit, personelin
20 audiovizivë, stenografët, teknikët edhe gjithë të tjerët.

21 E mbyll këtu seancën për sot.

22 --- Seanca përfundon në orën 15.51

23

24

25